



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 21, 22 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim i përkohshëm-depo, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtuesës me karakter të përkohshëm-depo, në kuadër të Planit Rregullues " Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 20.09.2019, merr këtë:

V E N D I M **PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE**

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Xhavit Krasniqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-123307/19 dt. 29.05.2019, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e ndërtuesës me karakter të përkohshëm-depo me etazhitë P+0, në kuadër të parcelës kadastrale nr.376-15 Zona Kadastrale Çagllavicë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të:

Planit Rregullues " Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 35-186850 të dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim "Zonë me përbajtje mikse";

Këto Kushte Ndërtimore përcaktohen në bazë të kritereve të " Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr.110-288305 dt.31.12.2014".

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 376-15, me S=400m², me pronar Xhavit Krasniqi, "Arë e klasës 4";
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr.376-15 ZK Çagllavicë, nuk ka ndërtesa të ndërtuara;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni i parcelës është i rrafshët ;
- Parcëla kadastrale ka qasje në rrugën lokale ekzistuese/publike;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin të ndërtuesës me karakter të përkohshëm në kuadër të Planit Rregullues " Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, bazuar në parametrat janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhitë i ndërtuesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtuesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;



- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës të jetë për afarizëm-depo, me karakter të përkohshëm;
- Shfrytëzimi i parcelës sipas gjendjes faktike të jetë max. 40%;
- Sipërfaqja e ndërtesës (sipas projektit të propozuar) është $S=160.00 \text{ m}^2$;
- Të respektohet etazhitë i ndërtesës e cila duhet të jetë përdhesë (P+0);
- Të sigurohet qasje e lirë, për automjetin e zjarrfiksave;
- Shfrytëzimi i nëntokës për bodrum nuk lejohet;
- Bazamenti i ndërtesës – themelet mund të jenë nga betoni i armuar;
- Ndërtesat e përkohshme duhet të ndërtohen nga materialet montuese dhe që lehtë demontohen, si: hekuri, druri, plastika, apo edhe ndonjë material tjetër i ngajshëm;
- Nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndërtimin e ndërtesave;
- Distancat e objekteve me karakter të përkohshëm nga kufiri i parcelës, duhet të përcaktohen sipas kritereve të planeve urbanistike. distancat mund të zvogëlohen deri në 120cm, me pëlqim të pronarëve të parcelave fqinje, kurse nëse në parcelat fqinjë ndodhen objektet ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve,
- Ndërtesa e përkohshme nuk shkaktojnë dëme për rrëthinen dhe ambientin, të mos paraqesin rrezik për zjarr apo eksplodim, dhe nuk duhet të emitojnë zhurmë.
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet patur kujdes të veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtarja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përbajtë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrëthinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimisione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe paralogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;

- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 376-15 ZK Çagllavicë, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar si kulturë "Arë e klasës 4", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit-'zgjidhja urbane'. Kjo sipërfaqë do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative përmarrjen e lejes ndërtimore.

IX Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, përrritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/çertifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Konratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

X.Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelave kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimit.

XI. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjeter, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Pronari Xhavit Krasniqi nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-123307/19 dt.29.05.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm-depo, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr.376-15, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914075-00376-15, ZK Çagllavicë;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale nr.376-16, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914075-00376-16, ZK Çagllavicë;
- Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re-Zona Perëndimore, me nr.ref.2205 dt.06.05.2019, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm-Prishtinë;
- Inçizimin gjeodezik për parcelën kadastrale nr.376-15 Zk Çagllavicë, punuar nga kompania gjeodete e licencuar N.P.N."VIA COM" me nr. të licencës 27 dt.23.05.2014, lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës-MMPH;
- Projektin konceptual të punuar nga.N.T.P"Pro Joni" nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.811298935;
- Akt notarial "Pëlqim" e përpiluar te noteri Burim Z. Xhemajli me.LRP Nr.2990/2019 me datë 30.07.2019, sipas të cilët Xhavit Krasniqi në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.376-15 Zk Çagllavicë, dhe "Albi Commerce"sh.p.k me nr. biznesit 80014724, në cilësinë e pronarit të parcelës nr.376-2 Zk Çagllavicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shabi Ramadani, jepin pëlqimin reciprok që secili në pronë të vet të ndërtojë lirshëm deri në kufi të parcelës fqinje në distancë zero;
- "Deklaratë" sipas të cilët Xhavit Krasniqi, pronar i pacelës nr.376-15 Zk Çagllavicë, deklaron se konform kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës, do ta largoj objektin brenda afatit të përcaktuar ligjor, konform pikës 2 të nenit 12 të Rregullores për Procedurën e brenda afatit të caktuar kohor sipas nenit 7 të Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e perosnave fizik dhe juridik, me nr.01 nr.110-288305, dt.31.12.2014; e vërtetuar te noterja Arbena Shehu me LRP.Nr.5563/2019 me datë 08.07.2019;
- Autorizimin përfaqësim nga Xhavit Krasniqi për Behar Krasniqi, që të e përfaqësojë pranë të gjitha institucioneve shtetërore Qëndrore dhe Lokale, si në Komunë, lidhur me nënshkrimin, pranim-dorëzimin dhe tërheqjen e të gjitha dokumentave për të cilat është e nevojshme prezenca e pronarit, e përpiluar te noterja Arbena Shehu, me LRP Nr.3597/2019 dt.02.05.2019;
- Vërtetimin e tatimit në pronë nr.116844/19 dt.22.05.2019 në emër të Xhavit Krasniqi;
- Fotokopjen e dokumentit të identifikimit-letërnjoftimit të pronarit Xhavit Krasniqi;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të shqyrtimit të kërkesës 05 nr.350/02 – 123307/19 dt.29.05.2019, për vazhdimin e procedurës ka kërkuar nga pala plotësimin e dokumentacionit, sipas shkresës zyrtare nr. 05-350/02-123307/19 dt. 19.06.2019, dhe atë plotësimin e këtyre pikave: Të ndryshohet dhe plotësohet projekti konceptual :Etazhiteti i ndërtesave me karakter të përkohshëm është vetëm përdhesë dhe ndërtesa e përkohshme duhet të kenë sipërfaqen bazë në parcelat e pandërtuara ,e cila nuk tejkalon 40% të saj; (të bashkangjitet CD në formë Dwg e projektit konceptual); Të respektohen distancat nga kufiri i parcelës bazuar në nenin 11 të Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizik dhe juridik nr.01.nr.110-288305, dt.31.12.2014; Të dorëzohet deklarata nga pronari i parcelës që do të largoj objektin e përkohshëm, në afat kohor të caktuar nga Organi kompetent komunal.

Pas plotësimit të dokumentacionit me nr.05-350/02-123307/19 dt.08.07.2019, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë

15.08.2019. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohe kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Sipas mendimit profesional nga faza e komunikacionit, të dt. 05.09.2019, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-350/02-123307/19 dt. 29.05.2019, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese "Hasan Hasani", sipas prezantimit në situacion për ndërtesën afariste-depo me etazhitet P+0, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e tillë, pasiqë kjo rrugë është e paraparë edhe me planin rregullues të "Prishtina e re-zona perëndim". Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes edhe në kohën kur realizohet ajo.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënim i përkategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projektin konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizik dhe Juridik 01 nr.110-288305 dt.31.12.2014, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shpjegë: Situacioni i ngushtë me zgjidhje urbane dhe situacioni i parcelës ndërtimore me vijë ndërtimore dhe vijë rregulluese nga plani rregullues ne sistemin Koordinativ KosovaRef01..

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

Ky Akt përcjellës u përpilua në 4(katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës.

Kopja elektronike e këtij Vendimi i dërgohet: Drejtorisë së Kadastër, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-123307/19 DT. 20.09.2019**

Zyrtari,
Leonora Mehmeti

u.d.Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo


Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREFO1

ZK. Çagllavicë



Punoi:

Kushtrim Domaneku.

Nënshtimi :

Prishtinë: 12.09.2019

Legjenda:

— Vija Rregulluese sipas PRRU

■■■■■ Vija Ndërtimore sipas PRRU

— Parcela Kadastrale

400m² X 0.4=160 m² Shputa e Ndertimit

Ruga Richard Hoolbruk

OBJEKTI NË PROCES TË LEGALIZIMIT

OBJEKTI NË KËRKIM TË KUSHTEVE NDËRTIMORE

~~OBJEKTI EGZISTUĒS~~

B+P+2

+20,00

+8.0

P+(

376-1

PROJEKTI IDEOR

ARKITEKTURA

JËRË

A

01

www.BipolarTreatment.com

- Legjenda
- Gjendja kadastrale
- Objekt
- Rrug ekzistuese
- Puset kanalizimi
- Muri
- Trafo elektrike
- Numri i parceles

Envi i Projektit:
**PROJEKTI IDEOR P+0
OBJEKTI AFARIST -DEPO
Prishtina e Re , Zona Perëndimore , Prishtinë**

Nenshkrimet:		Vufa:
Drejtori: Irxh.Dipl.Avi Falton IBRAHIMI		

PROJEKTI IDEOR	
Projekti: Projoni	Faza: ARKITEKTURA
Vizatimi:	SITUACIONI I GJËRË
Investitori	XHAVIT KRASNIQI
Perpjesa:	1 : 50
Data:	MAJ 2019
Projektant:	Inxh.Dip.Ark. Fatjon IBRAHIMI
Kontrollori:	
	Nr. i Fletes. A
	01